



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA PEQIN

.Nr.____.prot.

Peqin, më ____/____/2025

PROCESVERBAL- TIPI I KONTRATËS – SHËRBIME
ME
OBJEKT

“Sherbim mirembajtje mjetesh”

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

I mbajtur sot me date ____ ne Peqin prane Zyres se Prokurimeve , nga ana e Pergjegjesit te Njesise se Prokurimit i caktuar me urdherin **nr. datë** , te Titullarit te AK , me qellim zbardhjen e procesverbalit te argumentimit dhe miratimit te kerkesave te vecanta per kualifikim dhe specifikimeve teknike per proceduren e prokurimit e llojit „E Hapur e Thjeshtuar“, dhe ne referim te urdherit te prokurimit **nr. date** , me te dhenat si vijon:

OBJEKTI I PROCEDURËS: “Sherbim mirembajtje mjetesh ”.

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV):

- **Pjese kembimi per motore / (34144700-5).**

VLERA E FONDIT LIMIT: 3’333’333 (tremilion e treqind e tridhjetë e tremijë e treqind e tridhjetë e tre) lekë pa TVSH .

BURIMI I FINANCIMIT:Te ardhurat e Bashkise Peqin

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, autoriteti/enti kontraktor Bashkia Peqin ka hartuar procesverbalin për argumentimin e

specifikimeve teknike dhe kritereve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

I. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

a. *Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 9*

b. *Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3; (ne vleren prej 2% te fondit limit te kontrates)*

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme janë përcaktuar bazuar në nenet 76, 82 “Formulari përmbledhës i vetdeklarimit” , në nenin 83 ”Sigurimi i ofertes”, të Ligjit Nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik”, si dhe në nenin 30/1, të VKM-së Nr.285, datë 19.5.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik.

2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

2. Ofertuesi duhet të paraqesë:

1-a) Vertetim për shlyerjen e taksave dhe tarifave vendore përfshirë edhe detyrimet vendore për vitin 2024 të lëshuar nga ana e njësive vendore ku operatori ekonomik ka selinë sipas QKB, në rast se janë plotësuar afatet e maturimit të detyrimeve vendore për periudhën e mesipërme në përputhje me kërkesat e ligjit nr 9632 datë 30.10.2006 „Për sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar. (Edhe në rastet e bashkimit të operatoreve duhet të ketë vertetimin e shlyerjes së taksës vendore 2022 për secilin operator).

Argumentimi:Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 41, pika 5 në nenin 43, pika 6, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” dhe në ligjin nr.9632, datë 30.10.2006 “Për Sistemin e Taksave Vendore” i ndryshuar, në ligjin nr.9920 datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore” i ndryshuar, nën 3.1/a, b,



c dhe neni 40, ne ligjin nr.131/2015 “Per QKB” i ndryshuar, si dhe ne ligjin nr.9723 date 03.05.2007 “Per QKR” i ndryshuar.

Duke qenë se Autoriteti Kontraktor, Bashkia Peqin , është njësi e vetëqeverisjes vendore, e cila funksionon dhe ka kompetenca të përcaktuara sipas Ligjit Nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, Njësia e Prokurimit argumenton se pika 3 është vendosur në kuadër të Ligjit Nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e Taksave Vendore” (i ndryshuar), Neni 5, gërma “c” ku citohet se: “...përcakton numrin e kësteve të pagimit të taksës dhe afatet e kryerjes së tyre, si dhe kushtet lehtësuese në rastet e pagesës së plotë dhe përpara afateve të detyrimeve fiskale.

2.1. Përshtatshmëria për të kryer veprimtarinë profesionale (nëse është e aplikueshme):

a) Sipas percaktimeve te bera ne Shtojcen 9 te ketyre DT (**Kriteret e Përgjithshme të Pranimit/Kualifikimit**) pikat,1;2.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 1/a dhe 2, të LPP, nenit 41, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, si dhe nenit.....

(shënim: *plotësoni nëse është rasti, aktin konkret ligjor ose nëligjor që parashikon plotësimin e ndonjë kërkesë specifike për ushtrimin e veprimtarisë profesionale në fjalë*).

2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.a-Operatori/et Ekonomik duhet të paraqes/in kopje të deklarimit të xhiros vjetore per 3(tre) vitet e fundit ushtrimore/ financiare (2022,2023,2024) , ose vertetimin e lëshuar nga autoriteti përkatës, ku vlera e xhiros, për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar, duhet të jetë jo më e vogël se 40 % e vleres e fondit limit **te kontrates**, qe prokurohet përkatësisht: (133 333,32) **lekë pa TVSH**

Shenim-Pika 2.2-a) plotesohet duke paraqitur vertetimin perkates te Administrates Tatimore .

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, të LPP, si dhe nenin 43, pika 2/c të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” si dhe në legjislacionin e fushës ne fuqi, përkatësisht në Ligjin nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, VKM nr. 922 datë 29.12.2014 "Për deklarimin e detyrueshëm të deklaratave tatimore dhe të dokumenteve të tjera tatimore, vetëm nëpërmjet forms elektronike", si dhe në Udhëzimin e Ministrit të Financave nr.5, datë 30.01.2006, "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar,

Përcaktimi i vlerës është bërë brenda kufirit të vlerës të përcaktuar në rregullat e prokurimit publik dhe paraqitja e një dëshmie të lëshuar nga administrata tatimore vërteton besueshmërinë dhe kapacitetet financiare që ka një operator ekonomik ofertues nëpërmjet xhiros të realizuar në një nga këto tre vitet e fundit. Është e rëndësishme që ofertuesi para se të dorëzojë ofertën të kuptojë dhe të vlerësojë aftësitë/mundësitë e tij që lidhen me kapitalin e nevojshëm për



ekzekutimin me sukses te një kontrate të kësaj përmase që AK po prokuron.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar nënin 77 te LPP , si edhe ne nenin 43, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, pika 5 dhe 6, në zbatim të Ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, Udhëzimit të Ministrit të Financave Nr.5, datë 30.01.2006, "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, VKM-së Nr. 922 datë 29.12.2014 "Për deklarimin e detyrueshëm të deklaratave tatimore dhe të dokumenteve të tjera tatimore, vetëm nëpërmjet formës elektronike", si dhe kërkesave të Ligjit Nr. 25/2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”.

2.2.b Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin bilancet vjetore, për vitet financiare për një periudhë maksimumi tre vitet e fundit financiare 2022, 2023, 2024, të shoqëruara me Akt Ekspertizen e Ekspertit Kontabel te Autorizuar, vetëm në rastin kur janë në kushtet e përcaktimeve të nenit 41/c të Ligjit Nr.10091, datë 05.03.2009 “Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të ekspertit kontabël të regjistruar dhe të kontabilistit të miratuar”, i ndryshuar, ku bilancet e dy viteve të njëpasnjëshme, nuk duhet të kenë raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e bilanceve është bërë duke iu referuar legjislacionit të fushës, konkretisht: Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar ne legjislacioni tatimor ku xhiroja dhe bilancet kane si afat perfundimtar per tu mbyllur dhe dorezuar prane organeve tatimore maksimumi deri ne fund te muajit Prill te vitit qe vjen. Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e bilanceve është bërë bazuar sipas ligjit nr.8438 date 28.12.1998 i ndryshuar. Shoqërimi me Akt Ekspertizen e Ekspertit Kontabel te Autorizuar, vetëm në rastin kur janë në kushtet e përcaktimeve të nenit 41/c të Ligjit Nr.10091, datë 05.03.2009 “Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të ekspertit kontabël të regjistruar dhe të kontabilistit të miratuar”, i ndryshuar.

(Shënim: citoni dispozitën përkatëse të legjislacionit tatimor, ku përcaktohen rastet kur personat juridikë kanë detyrimin që të kryejnë auditimin ligjor të pasqyrave financiare vjetore, përpara publikimit të tyre, nga eksperte kontabël ose shoqëri audituese).

2.3 Aftësitë teknike dhe profesionale:

2.3.1-Përvojë e suksesshme në realizimin e të paktën:

a)Operatori ekonomik duhet te paraqese dëshmi për furnizimet e shërbimeve te mëparshme, të ngjashme me objektin e prokurimit, të kryera gjatë tri viteve të fundit nga data e shpalljes se njoftimit te kontrates me një vlerë sa 20% e vlerës së përllogaritur të kontratës/lotit që prokurohet dhe konkretisht ne shumen **666’666 (gjashtëqind e gjashtedhjetë e gjashtë mijë e gjashtëqind e gjashtedhjetë e gjashtë) lekë pa**

b)Për të vërtetuar këtë Operatoret Ekonomik duhet të paraqesin:

- Kur furnizimi i shërbimeve te mëparshme te ngjashme, është realizuar me institucione shtetërore,Operatori ekonomik do ta vërtetojë duke paraqitur vërtetimin e lëshuar nga Institucioni shtetëror për realizimin e sukseshëm të kontrates si dhe fatura tatimore të shitjes,të plotësuar sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat

dhe shërbimet e realizuara, të nënshkruara nga të dyja palët.

- Kur furnizimi i shërbimeve të mëparshme të ngjashme është realizuar me subjekte private, Operatori ekonomik do ta vërtetojë këtë furnizim duke paraqitur vetëm faturën përkatëse tatimore të shitjes të plotësuar sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara, të nënshkruar nga të dyja palët.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenin 41, pika 3 dhe nenin 55, pika 4/b, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që shërbimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më pak se 20 % të vlerës së fondit limit, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme është vendosur brenda kufirit të vlerës të përcaktuar në rregullat e prokurimit publik dhe i shërben AK për të treguar se ofertuesit me kapacitetet e tyre kanë realizuar kontrata të ngjashme me objektin që prokurohet në vlerën prej 20% të fondit limit, në afat dhe me cilësi dhe rrit besueshmërinë mbi përvojën që ka ofertuesi në treg. Përvoja e ngjashme është një “kompetencë thelbësore”, ndaj operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmi të tilla fatura tatimore për ta provuar kryerjen e tyre qoftë me sektorin privat dhe atë publik.

2.3.2-a) Operatori ekonomik ofertues duhet të disponoj (në pronësi / me qera / huapërdorje), ambjent për ushtrimin të aktivitetit të tij (lidhur me riparimin e mirmbajtjen e automjeteve), në një sipërfaqe prej 300 m² ndertese, ku të përfshihen parkimi mjeteve + servisi + magazina pjesëve të këmbimit + ambjente shërbimi të jashtme në funksion të aktivitetit riparim të automjeteve) me vendndodhje/adrese në territorin e qytetit të Peqinit.

Në lidhje me këto pike operatori ekonomik duhet të paraqesë sipas rastit:

Dokument që vërteton pronësinë, ose huapërdorjen, ose qiramarrjen si më poshtë:

Dokumentacioni që vërteton pronësinë, Çertifikata e pronësisë, e lëshuar nga autoriteti kompetent ose, kontrata e shitblerjes; ose, kontrata e dhurimit; ose, çdo dokument tjetër, me anë të të cilit fitohet e drejta e pronësisë, sipas Kodit Civil të Republikës së Shqipërisë.

Dokumentacioni që vërteton huapërdorjen: Kontratën respektive (të vlefshme për gjatë gjithë periudhës së afatit të realizimit të shërbimit) të sipërfaqes që zoteron.

Dokumentacioni që vërteton marrjen me qira: Kontratë qiraje (të vlefshme për gjatë gjithë periudhës së afatit të realizimit të shërbimit) të sipërfaqes që zoteron.

Shënim- Për të përmbushur këto kriter, në fazën e ofertimit është e mjaftueshme paraqitja e deklaratës, sipas **shtojcës nr.9**, ndërsa operatori ekonomik i klasifikuar i pari, në përputhje me nenin 26.6 të VKM Nr. 285, datë 19.5.2021, duhet të dorëzojë dokumentacionin provues si më sipër referuar



Argumentimi-Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 41, pika 4/ ç, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion mjetet dhe pajisjet teknike për të përmbushur kontratën, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit. Nisur nga fakti se shërbimi që ofrohet objekt i kësaj kontrate është riparimi dhe mirëmbajtja e automjeteve, te cilat duhet të dërgohen në ambjentet e servisit të përcaktuar nga autoriteti kontraktor është e domosdoshme që operatorët ekonomik duhet të dëshmojnë që kanë minimalisht, 1 (një) ambjent ku ushtron aktivitetin e tij me qëllim realizimin të objektit të prokurimit. Siperfaqja e ambientit kërkohej të jete 300 m2 nisur nga fakti se ky ambient do të shërbeje për riparimin e mjeteve por edhe për parkimin e tyre gjatë kohës së riparimit.

Ndërsa vendndodhja kërkohej të jete në qytetin e Peqinit nisur nga fakti se në listën e mjeteve që do të riparohen janë dhe mjete të renda për të cilat nevojiten kosto shtesë për transportimin e tyre dhe për këtë arsye është vendosur të përzgjidhet si kriter afërsie me vendndodhjen e mjeteve të cilat janë në parkimin e Bashkisë në qytetin e Peqinit.

2.3.3 Operatorët ekonomik pjesëmarrës duhet të kenë të punësuar staf teknik për kryerjen e të gjitha shërbimeve në këtë objekt, staf inxhinierik si më poshtë:

- Një inxhinier mekanik (1)

Për inxhinierin si më sipër duhet të paraqesi kontratë pune të vlefshme (me afat vlefshmërie brenda afatit të realizimit të shërbimit për këtë objekt), diploma dhe librezë e punës.

Shënim- Për të përmbushur këtë kriter, në fazën e ofertimit është e mjaftueshme paraqitja e deklaratës, sipas **shtojcës nr.9**, ndërsa operatori ekonomik i klasifikuar i pari, në përputhje me nenin 26.6 të VKM Nr. 285, datë 19.5.2021, duhet të dorëzojë dokumentacionin provues si më sipër referuar

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 41, pika 4/ b) dhe c), të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë stafin, personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës.

Autoriteti Kontraktor ka kërkuar që kontraktuesi duhet të përcaktojë një person përgjegjës me kompetenca teknike për kryerjen e shërbimeve të cilat kanë një rol të rëndësishëm në mbarëvajtjen e shërbimeve e pasi ata janë përgjegjës për zbatimin e tyre dhe në përputhje me kushtet teknike të zbatimit të tij. Dokumentacioni plotësues i kërkuar në kriteret e vecanta për kualifikim pjesë përbërëse e dokumentave të tenderit, sikundër janë, kontratë pune të vlefshme, diploma etj janë vendosur për arsye se me paraqitjen e këtij dokumentacioni vërtetohet se ky person përgjegjës është operativ pranë Ofertuesve të mundshëm dhe në këtë mënyrë Autoriteti Kontraktor krijon bindjen se Operatorët ekonomikë pjesëmarrës zotërojnë personelin e nevojshëm për realizimin me sukses të objektit që prokurohet. Stafi teknik i kualifikuar është kërkuar në raport me shërbimet që



kerkohen te realizohen te cilat jane te profilit mekanik. Bazuar në parashikimet e mësipërme të legjislacionit për prokurimin publik, Autoriteti Kontraktor ka kërkuar që operatori ekonomik ofertues duhet të ketë në stafin e tij punonjës te afte profesionalisht per realizimin e objektit.

Operatori ekonomik duhet të disponojë punonjës të specializuar/të kualifikuar, si më poshtë:

2.3.4 Personeli mbështetës i kualifikuar dhe teknik

a) Operatori ekonomik ofertues duhet të ketë personelin teknik të nevojshëm për realizimin e kontratës, në përbërje të të cilit të ketë minimalisht 5 (pese) punonjës sipas profilit të mëposhtme:

- 5 (pese) mekanik

Për cdo profil punonjesi teknik si me siper duhet të paraqitet, duhet të paraqitet si dokuemtacion provues :

- kontrata individuale të punës e vlefshme pergjate gjithe peridhes se afatit te realizimit te sherbimit ;
- një dokument që të vërtetojë kualifikimin profesional (dëshmi kualifikimi profesional/certifikatë/diplomë), lëshuar nga institucione (shtetërore apo private) të licencuara/akredituara nga autoritetet përgjegjëse shtetërore

Shenim- Per te permbushur kete kriter , ne fazen e ofertimit është e mjaftueshme paraqitja e deklarates, sipas **shtojcës nr.9** , ndersa operatori ekonomik i klasifikuar i pari, ne perputhje me nenin 26.6 te VKM **Nr. 285, datë 19.5.2021** , duhet te dorezoje dokumentacionin provues si më siper referuar

Argumentimi:Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 41, pika 4/b), të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës.

Referuar natyres se shërbimeve që kërkohen të prokurohen sic jane riparime dhe mirmbajtje të agregatit të motorrit, të karrocise, etj eshte e nevojshme pajisja e nje stafi teknik me profesione si mekanik , vertetuar kjo ne baze te legjislacionit te punes e të profesioneve të përcaktuara në Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr. 514, datë 20.09.2017 “Për miratimin e listës kombëtare të profesioneve (LKP), të rishikuar” për realizimin me sukses të kontrates. Ky numer minimal është kërkuar duke u bazuar ne numrin e automjeteve qe kane nevojte per kryerjen e sherbimeve si dhe natyren dhe numrin e sherbimeve qe kerkohen. Bazuar në parashikimet e mësipërme të legjislacionit për prokurimin publik, Autoriteti Kontraktor ka kërkuar që operatori ekonomik ofertues duhet të ketë në stafin e tij punonjes te afte profesionalisht per realizimin e objektit.

2.3.5--Dëshmi për mjetet e pajisjet teknike, që ka në dispozicion apo mund ti vihen në dispozicion operatorit ekonomik, që nevojiten për ekzekutimin e kontratës.



Kandidati/ofertuesi duhet te disponoje makinerite dhe mjetet si vijon ne pronesi ose me qera.

- a) paisje për diagnostifimin e defekteve te mjeteve (1)(nje).
- b) paisje urë ngritese për automjetet, të paktën 1 (një) urë;
- c) paisje për zmontimin dhe montimin e gomave në diskun e gomës të mjetit (1)(nje)(konvergjence).

Për pajisjet dhe instrumentet e mësipërme, operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë dokumentat provuese që vërtetojnë se, këto pajisje/mjete apo instrumente i ka në pronësi, ose me qera, ose me huapërdorje sipas rastit , ku perfshihen (fatura tatimore te blerjes / akte zhdoganimi / kontrata qiraje e vlefshme per te gjithë periudhen e realizimit te kontrates / kontrata huapërdorje e vlefshme per te gjithë periudhen e realizimit te kontrates / kontrate dhurimi / çdo dokument tjetër me anë të të cilit fitohet e drejta e pronësisë ose përdorimit sipas Legjislacionit perkates ne Republiken e Shqiperise).

Shenim- Per te permbushur kete kriter , ne fazen e ofertimit është e mjaftueshme paraqitja e deklarates, sipas **shtojcës nr.9** , ndersa operatori ekonomik i klasifikuar i pari, ne perputhje me nenin 26.6 te VKM Nr. 285, datë 19.5.2021 , duhet te dorezoje dokumentacionin provues si më siper referuar

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 41, pika 4/ ç, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021“Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion mjetet dhe pajisjet teknike për të përmbushur kontratën, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit. Nisur nga fakti se objekt i kësaj kontrate është riparimi dhe mirëmbajtja e automjeteve, te cilat duhet të realizohen sipas specifikimeve teknike, ku nje pjese e tyre mund te ofrohet nga OE duhet të dëshmojnë që kanë minimalisht ambientin e prodhimit, makineritë, pajisjet, asetet e nevojshme të përcaktuara më sipër si dhe kapacitetet njërëzore, stafin e nevojshëm dhe kualifikimet profesionale me qëllim realizimin te objektit te prokurimit.Ky kriter është vendosur, gjithashtu edhe për arsye se është cmuar si e nevojshme zotërimi i makinerive të sipërmëndura nga OE, të domosdoshme për riparimin dhe mirembajtjen e automjeteve. Referuar natyrës së objektit të prokurimit riparim dhe mirëmbajtje të automjeteve për realizimin me sukses të shërbimeve është e nevojshme pasja e nje sërë pajisjesh dhe makinerish. Duke u bazuar në numrin e automjeteve që disponon AK si dhe llojet e shërbimeve qe kërkohen te kryhen janë kërkuar të gjitha pajisjet e nevojshme.

Makinerite e pajisjet te cilat jane kerkuar si me siper nga ana e AK jane te nevojshme per te kryer proceset specifike te punes qe kerkon ekzekutimi me sukses i objektit te kontrates, pasi ne zerat respektiv te preventivit jane parashikuar procese te tilla qe kerkojne angazhimin e ketyre makinerive dhe pajisjeve.



II. Argumentimi i specifikimeve teknike

Specifikimet Teknike per proceduren respektive jane hartuar nga Drejtoria e Sherbimeve Publike qe ka hartuar edhe elementet e tjere plotesues te dokumentacionit teknik te dokumentacionit perkates te ekzekutimit te kontrates duke qene elemente perberes te tij dhe qe jane administruar nga ana e Njesise se Prokurimit Publik me shkresen **nr. ____prot date** . Ne hartimin e tyre jane marre ne konsiderat kerkesat ligjore te fushes se mirmbajtjes dhe qarkullimit te mjeteve ne Republiken e Shqiperise

Me anë të kësaj procedure synohet mbajtja në gadishmëri teknike e automjeteve të transportit që ka në përdorim Bashkia Peqin dhe konkretisht në procedurë janë përfshirë gjithsej _____ mjete, të llojeve të ndryshme, sipas natyres dhe funksionit specifik.

Zërat e shërbimeve janë hartuar bazuar në llojet e mjeteve në përdorim/shërbim të Bashkis Peqin referuar shërbimeve të parashikuara në një periudhë të afërt dhe mundësisë të defekteve të ndodhura nga përvija e viteve të shkuara.

Referenca ligjore për specifikimet teknike: neni 36, i ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe neni 15, pika 3/b, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”.

Specifikimet Teknike dhe Termat e References janë pjesë e setit të dokumentave të ngarkuara në SPE për procedurën respektive.

- **Fondi Limit i perlllogaritur per kete procedure eshte hartuar ne baze te kerkesave specifike te nenit 34 te Ligjit nr 162/2020 ''Per Prokurimin Publik'' dhe nenit 76.1. te VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”.Cmimet reference te preventivit per cdo ze jane marre referuar testimit te tregut per sherbimet e ngjashem komponente te preventivit te sherbimit..**

*Shënim: Përcaktoni specifikimet teknike, për shërbimet objekt prokurimi, që do të përfshihen në termat e referencës, në përputhje me parashikimet e nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të LPP, si dhe nenit 41, pika 1, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, **duke argumentuar çdo kërkesë funksionale ose performance, apo/dhe çdo standard të kërkuar**, ku çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët “ose ekuivalenti i tij/saj”.*

Kujdes: Në specifikimet teknike, nëse nuk e justifikon objekti i kontratës, nuk duhet të përmendet asnjë markë prodhimi ose burim specifik apo proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një operator ekonomik specifik apo asnjë markë tregtare, patentë, tipi ose origjinë apo prodhim specifik, me qëllim favorizimin ose eliminimin e disa sipërmarrjeve ose produkteve. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste përjashtimore kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme e përshkrimit të objektit të kontratës, sipas pikës 3 të nenit 36, të LPP. Referime të tilla duhet të shoqërohen nga fjalët “ose ekuivalente”.

